

MANUALI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



Rruga "Naim Frashëri", Nr.37
Tiranë, Shqipëri, 1000

Phone: 04256440

Web: <https://www.ascap.edu.al/>

Drejtoria e Performancës

Tiranë, Tetor 2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 460/2 Prot.

Tiranë, më 16.3. 2022

URDHËR

Nr. 130, datë 16.3. 2022

PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS
SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR DHE MANUALIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 11, të nenit 6 dhe të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" dhe vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar dhe Manualit të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Evis KUSHI



**MANUALI
I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS
SË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
Drejtoria e Performancës**

Tiranë, Tetor 2021

PARATHËNIE

Në Shqipëri, deri më sot, ka pasur raporte statistikore vjetore të dhënash për gjendjen e sistemit arsimor, por nuk ka pasur vlerësim shterues të performancës së sistemit nëpërmjet të cilit të evidentohen arritjet dhe defektet në të gjitha shtyllat kyçe të sistemit si dhe të jepen rekomandime dhe, mbi bazën e tyre, të hartohen politika në funksion të përmirësimit të cilësisë që ofron sistemi arsimor.

Manuali i Vlerësimit të Performancës është një ogur i mirë për specialistët e fushës së arsimit dhe të gjithë grupet e interesit të cilët do të kenë mundësinë të merren me monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e arsimit dhe vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri. Vlerësimi i performancës do t'u shërbejë politikëbërësve të orientohen më mirë në vendimmarrje.

Ky dokument do të krijojë mundësi për të krahasuar performancën e sistemit arsimor në Shqipëri me vende të tjera në rajon dhe në Evropë, për të konstatuar se ku jemi në raport me vendet e tjera dhe për të adaptuar praktika që në ato vende kanë rezultuar të suksesshme. Ky manual gjithashtu do të shërbejë për të reflektuar mbi cilësinë e shërbimit arsimor dhe vendosjen e objektivave reale, të mundshme, referuar kontekstit dhe kapaciteteve njerëzore e financiare.

Së fundmi, me anë të këtij dokumenti do të mund të vetëdijesohemi mbi panoramën e përgjithshme të gjendjes aktuale të sistemit arsimor, arritjet, vështirësitë dhe sfidat, duke na lejuar kështu, të gjykojmë mbi kahet e duhura drejt përmirësimit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

1. PARIMET KRYESORE TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

2. QËLLIMI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

3. FUSHA E VEPRIMIT

4. PËRGJEGJËSITË PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT

5. KONTEKSTI I VLERËSIMIT TË SISTEMIT

5.1. Kuadri makro-ekonomik dhe fiskal

5.2. Situata demografike

5.3. Kuadri i politikave

5.4. Kuadri ligjor dhe institucional

6. ANALIZA E GJENDJES

6.1. Faktorët (ekonomik, politik, social dhe teknologjik)

6.2. Arsimi parauniversitar

6.3. Barazia gjinore

6.4. Financimi i arsimit

7. HIERARKIA E QËLLIMEVE TË STRATEGJISË

8. VIZIONI KOMBËTAR PËR ARSIMIN

9. PROCESI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

9.1. Qëllimi i politikës A

9.1. Qëllimi i politikës B

10. KRITERET E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

11. BURIMET FINANCIARE

12. RAPORTI I VLERËSIMIT

13. KONKLUZIONE

14. REKOMANDIME

15. FORMATET E VLERËSIMIT

ANEKSI 1: Formatet e vlerësimit të performancës

Modeli 1: Formati i vlerësimit të realizimit të masës/veprimtarisë;

Modeli 2: Formati i vlerësimit të realizimit të produktit;

Modeli 3: Formati i vlerësimit të realizimit të objektivit;

Modeli 4: Formati i vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës;

Modeli 5: Formati i vlerësimit të performancës së sistemit.

ANEKSI 2: Formati i Raportit të Vlerësimit të Performancës

16. REFERENCAT

SHKURTIMET

ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
INSTAT	Instituti i Statistikave
KSHK	Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
NjVV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PBA	Programi buxhetor afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PKAB	Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar
SAPU	Sistemi Arsimor Parauniversitar
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
VANAF	Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

HYRJE

Ligji 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar [1], përcakton objektivat e përgjithshme të arsimit parauniversitar në Shqipëri. Ligji përcakton gjithashtu parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe drejtimin e arsimit parauniversitar. Ndryshimet e fundit të këtij ligji janë ndërmarrë në funksion të zbatimit të kurrikulës së re mbi bazë kompetencat, krijimin e strukturave të reja, brenda sistemit arsimor parauniversitar (SAPU), si dhe ndërtimin e mënyrave bashkëkohore të drejtimit të institucioneve arsimore.

Këto ndryshime kanë krijuar kushte ligjore për zhvillimin e kompetencave të nxënësve në formën e njohurive shumëfunktionale: shprehitë, aftësitë dhe prirjet për realizimin personal, integrimin social dhe ekonomik, si dhe respektin për të drejtat e njeriut. Ndryshimet kanë krijuar gjithashtu mundësi për mësuesit, për t’u punësuar nëpërmjet konkurrimit në portalin “Mësues për Shqipërinë” [2], bazuar në aftësitë individuale, duke shmangur integrimin në sistem nëpërmjet korrupsionit, apo preferencave politike.

Manuali i Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar është një dokument që shërben për të treguar se çfarë rruge duhet ndjekur për të realizuar procesin e vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri. Ky dokument do jetë në dispozicion të strukturave përgjegjëse, si orientues për njohjen e elementëve të procesit të vlerësimit, si: grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, analiza mbi bazën e qendëruar e të dhënave, monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave të parashikuara në planin strategjik dhe në fund hartimi i raportit të vlerësimit të performancës së sistemit.

Manuali i Vlerësimit të Performancës së SAPU-së është modeli i parë i këtij lloji në Shqipëri, i cili u shtohet manualeve ekzistuese në fushën e arsimit. Ky manual do të jetë një udhërrëfyes, ku përcaktohen përgjegjësitë, mjetet dhe kriteret që do të zbatohen në vijim për vlerësimin e sistemit.

Krijimi i të dhënave të standardizuara mbi rezultatet e nxënësve dhe informacioni i përditësuar që lidhet me procesin e të mësuarit, ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin e performancës së sistemit arsimor. Institucioni i vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, do të grumbullojë në mënyrë kronologjike të dhënat mbi ecurinë e realizimit të qëllimeve të politikave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 - SKA [3] dhe mbi bazën e analizës së tyre do të informojë publikun, si dhe do të bëjë propozimet përkatëse për hartimin e politikave në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit arsimor në Republikën e Shqipërisë dhe garantimit të performancës së sistemit.

Vlerësimi i sistemit dhe dhënia e rekomandimeve nga institucioni i sigurimit të cilësisë, do të ndihmojë për përdorimin më të mirë të të dhënave në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së shërbimit arsimor.

Performanca e sistemit arsimor, ndër të tjera do të matet edhe në raport me treguesit e certifikuar që monitorohen nga institucione ndërkombëtare si BE (EUROSTAT), OKB (UNESCO) [4] dhe OECD [5]. Krahasimi i treguesve të sistemit tonë arsimor me ato të sistemeve arsimore të vendeve më të zhvilluara, është një nga faktorët nxitës për reformimin dhe përmirësimin e sistemit.

1. PARIMET KRYESORE TË VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Parimet kryesore të vlerësimit të performancës së SAPU-së janë:

1. Saktësia
2. Drejtësia
3. Besueshmëria
4. Dobia

2. QËLLIMI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Dy qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së SAPU-së janë:

- a) Nxitja e llogaridhënies së aktorëve të sistemit arsimor, për përmbushjen e objektivave në funksion të qëllimit të politikave.
- b) Përmirësimi i politikave arsimore dhe rritja e rezultateve të sistemit, nëpërmjet shfrytëzimit të informacionit të saktë për gjendjen e sistemit.

Vlerësimi i performancës së sistemit arsimor do të shërbejë, nga njëra anë, si mekanizëm llogaridhënieje nëpërmjet raportimit të të dhënave për rezultatet e arritura për publikun e gjerë dhe, nga ana tjetër, si bazë për përmirësimin e politikave arsimore në vijim. Krijimi i standardeve më të përparuara të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe raportimi i saktë për publikun do të forcojë llogaridhënien dhe do të nxisë përdorimin sistematik të të dhënave për hartimin dhe realizimin e politikave të reja.

Fuqizimi i monitorimit dhe vlerësimit merr një vëmendje të posaçme, me qëllim mbledhjen e të dhënave, raportimin, publikimin dhe komunikimin në kohë të rezultateve, si dhe analizën e tyre në funksion të hartimit të politikave dhe vendimmarrjes.

Në funksion të realizimit të qëllimeve kryesore, ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e informacionit, posaçërisht ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit (SMIP), përbën prioritet kryesor për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor, në kohë e me cilësi.

3. FUSHA E VEPRIMIT

Vlerësimi i performancës së SAPU-së përfshin një fushë veprimi që merr parasysh të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët ndikojnë në ecurinë e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri. Fusha e veprimit në procesin e vlerësimit të performancës së sistemit përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave specifik në funksion të realizimit të qëllimit të politikave të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit (SKA).

Secili nga objektivat ka produktet dhe masat/veprimtaritë e planifikuara për realizimin e tyre.

Brenda fushës së veprimit nëpërmjet procesit do të bëhet vlerësimi për:

- Performancën e sistemit arsimor, si formë llogaridhënie e aktorëve përgjegjës, në raport me objektivat e vendosur në SKA.

- Funksionimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit të SKA-së, si program afatgjatë për përparimin e rezultateve kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi.

Realizimi i vlerësimit të performancës së sistemit arsimor është një proces kompleks që kushtëzohet nga disa faktorë:

- **Së pari**, vlerësimi kërkon burime dhe kapacitete njerëzore të kualifikuara për ta realizuar procesin.
- **Së dyti**, gjatë zbatimit të planit të veprimit, ndodhin ndryshime të paparashikuara politike, legjislativë dhe institucionale, të cilat kërkojnë përshtatje të strukturave, burimeve njerëzore dhe financiare me procesin.
- **Së treti**, procesi i vlerësimit të sistemit realizohet në një kontekst të gjerë, ku zhvillimi i sistemit arsimor është i lidhur me të gjitha zhvillimet ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri dhe në qendër të vëmendjes është nxënësi.

4. PËRGJEGJËSITË PËR VLERËSIMIN E SAPU-së

Ministria përgjegjëse për arsimin, ndër të tjera, ka përgjegjësinë për zhvillimin e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri [6]. Ajo ushtron këtë rol nëpërmjet strukturave të saj, në qendër dhe në bazë, si dhe nëpërmjet institucioneve të varësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, përgjegjëse për politikën, e inkuadruar në strukturën e ministrisë përgjegjëse për arsimin, është e ngarkuar me hartimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit të arsimit. Kjo drejtori është gjithashtu përgjegjëse për koordinimin e përgatitjes së projekteve dhe zhvillimit të programeve si dhe për raportimin e strategjive kombëtare në fushën e arsimit.

Institucionet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që janë pjesë e përgjegjësisë për sigurimin e cilësisë të sistemit arsimor parauniversitar, janë:


- a) Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë, që ka për mision garantimin dhe vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimimit parauniversitar publik e privat, në përputhje me kurrikulën e bazuar në zhvillimin e kompetencave (sot ASCAP).
- b) Institucioni përgjegjës për inspektimin/kontrollin e institucioneve arsimore, bashkë me degët rajonale/vendore, që ka për detyrë garantimin e ofrimit të shërbimit cilësor në sistemin arsimor parauniversitar, nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit, në përputhje me politikën, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar si dhe transmetimin e të dhënave për institucionin e sigurimit të cilësisë (sot DPAP).
- c) Institucioni përgjegjës për provimet kombëtare, i cili kryen procesin e organizimit dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve nëpërmjet provimeve kombëtare dhe administron bazën e të dhënave të rezultateve (sot QSHA).
- d) Institucioni përgjegjës për lidhjen ndër-institucionale dhe menaxhimin e të dhënave (sot RASH), i cili është një institucion bashkëpunues me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Përtej rolit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Instituti i Statistikave (INSTAT) ka një rol të rëndësishëm në mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave, si dhe është përgjegjës për krijimin e një pakete treguesish kombëtarë për arsimin. INSTAT është përgjegjës për të gjitha të dhënat që i raportohen EUROSTAT-it, si dhe për monitorimin e përparimit të Shqipërisë në procesin e integritit evropian.

Institucionet përgjegjëse për vlerësimin e sistemit arsimor në Shqipëri

- Ministria përgjegjëse për arsimin
- Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë
- Institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në sistemin arsimor parauniversitar
- Institucioni përgjegjës për provimet kombëtare
- Institucioni përgjegjës për ndërlidhjen akademike
- Instituti i Statistikave

Skema i institucioneve kontribuese për vlerësimin e performancës



5. KONTEKSTI I VLERËSIMIT TË SISTEMIT

5.1. Kuadri makro-ekonomik dhe fiskal

Në këtë kuadër jepet ritmi i rritjes së vazhdueshme ekonomike, krahasueshmëria me vitet e kaluara dhe parashikimi i PBB (Prodhimi i brendshëm bruto për vitet në vijim) [7]. Këto tregues ndikojnë në ritmet e punësimit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë të rinjtë e moshës 15-24 vjeç. Në këtë kuadër jepen: a) rritja reale e PBB-së përgjatë viteve dhe b) treguesit e makroekonomikë për periudhën e vlerësimit ku përfshihen: popullsia, inflacioni mesatar, rritja e PBB-së (%), papunësia, të ardhurat dhe shpenzimet totale në raport me PBB-në.

5.2. Tabloja demografike

Në këtë tablo, nëpërmjet projeksioneve demografike në rang kombëtar dhe rajonal, jepen skenarët zhvillimit të popullsisë, rritjes ose tkurrjes, për periudha 5-10 vjeçare.

5.3. Kuadri i politikave

5.3.1. Dokumentet e politikave të brendshme

Në këtë kuadër përfshihen strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, si dhe dokumentet e politikave që ndërlidhen me zhvillimin e arsimit, si:

- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 [8].
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 [9].
- Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023 [10].
- Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale 2020-2025". [11].
- Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024.
- Strategjia e Kombëtare e Arsimit 2021-2026 (SKA)
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. [12].

5.3.1. Dokumentet ndërkombëtare

Në këtë kuadër, bëjnë pjesë dokumente ndërkombëtare në hartimin e disa prej të cilave ka marrë pjesë edhe Republika e Shqipërisë. Disa nga këto dokumente lidhen me studime, vlerësime dhe rekomandime të institucioneve ndërkombëtare, lidhur me arsimin në Shqipëri dhe perspektivën e tij.

Disa nga dokumentet kryesore janë:

- Raporti Vjetor i Bashkimit Evropian [13].
- Rezoluta e Këshillit të Evropës *"Për një kornizë strategjike për bashkëpunimin evropian në arsim dhe trajnim drejt Fushës Evropiane të Arsimit dhe më gjerë"*, (2021-2030) [14].
- UNESCO *"Shqipëria: rishikimi i politikave arsimore; çështjet dhe rekomandimet, raporti i zgjeruar"* [15].
- OECD, *"Rishikimet e OECD-së për Vlerësimin"*, Shqipëri [16].
- Agjenda 2030, *"Për Zhvillim të Qëndrueshëm"*, OKB [17].

5.4. Kuadri ligjor dhe institucional

5.4.1. Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit parauniversitar përbëhet nga tre ligje kornizë:

- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar.

Aktet nënligjore më kryesore janë:

- VKM Nr. 98, datë 27.02.2019, “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) [18]”.
- VKM Nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” [19].
- VKM Nr. 540, dt. 19.09.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar e mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre” [20].
- Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, Tiranë 2021.

5.4.2. Struktura e sistemit të arsimit

Skema e organizimit të Sistemit Arsimor në Shqipëri

ISCED Niveli	Mosha fillimit	Klasa	Programi arsimor (provimet ku aplikohet)			
Niveli	24/25		Arsim i lartë - Doktoratë			Specializime afatgjata
7	22/23		Arsim i lartë - programet Master		Studime të integruara të ciklit të dytë	
6	18/19		Arsim i lartë - programet Bachelor			
5	18/19					Diplomë ose certifikatë profesionale pas arsimit të mesëm të lartë
	18		Provimi i Maturës Shtetërore			
3	15	12	Arsimi i mesëm i lartë – gjimnaz	Arsimi i mesëm i lartë – i orientuar (mund të jetë 3 ose 4 vite)	AML – profesional i profilizuar	AML profesional teknik/ drejtues (mund të jetë 2+1+1 or 2+2 vite)
		11			AML – profesional	AML – profesional
		10				
	14/15		Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë			
2	12	9	Arsimi Bazë – Arsimi i Mesëm i Ulët			
		8				
		7				
		6				
	11		Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor (VANAF)			
1	6	5	Arsimi bazë – Arsimi fillor			
		4				
		3				
		2				
		1				
0	5-6		Arsimi parashkollor - klasa përgatitore			
	4-5		Arsimi parashkollor- kopsht			
	3-4					

Arsimi parashkollor zgjat nga mosha 3-6 vjeç. Për moshën 5-6 vjeç, në disa institucione arsimore, janë ngritur klasa përgatitore.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët përbëjnë arsimin bazë, i cili zgjat 9 vjet dhe është i detyrueshëm.

Arsimi i mesëm i lartë karakterizohet nga tërheqja e madhe e nxënësve nga arsimi bazë (rreth 95%). Llojet e arsimit të mesëm të lartë janë: gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i mesëm i orientuar. Gjimnazi përbëhet nga tri klasa, ndërsa nxënësve, që kanë mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk e kanë përfunduar gjimnazin, u mundësohet ndjekja e gjimnazit me kohë të pjesshme ose në distancë.

Arsimi i mesëm profesional është me kohëzgjatje dy deri katërvjeçare dhe është i strukturuar në tri nivele kualifikimi, në përputhje me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Shkolla të arsimit të orientuar janë shkollat artistike, shkollat sportive, shkollat për gjuhët e huaja dhe shkolla për fusha të tjera të të nxënësve.

Procesi mësimor në arsimin parauniversitar zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa në zonat ku jetojnë pakica kombëtare greke dhe maqedonase edhe në gjuhët e tyre.

Në institucionet e arsimit të lartë (IAL) programet e studimeve organizohen në tri cikle.

Pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë IAL ofrojnë edhe programe studimi me karakter profesional, me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike 60 -120 ECTS dhe në përfundim të tyre lëshohet “certifikatë profesionale” ose “diplomë profesionale”.

Studimet e ciklit të parë zgjasin 3 vite akademike. Me përfundimin e studimeve lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Ligji parashikon tri lloje të programeve të studimit të ciklit të dytë: **Master profesional, Master i shkencave dhe Master i arteve.**

Programet “Master profesional” i pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar dhe organizohen me 60 -120 ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.

Programet “Master i shkencave” i pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është 2 vite akademike (120 ECTS).

Programet “Master i arteve” i pajisin studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e arteve dhe ofrohen nga institucione të arsimit të lartë me kohëzgjatje 2 vite akademike (120 ECTS). Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale, respektivisht, pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, veterinarisë e arkitekturës.

Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve “Master ekzekutiv”, programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të KSHK-së.

Programet e studimeve “Master ekzekutiv” ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional dhe kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike.

Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri praktike për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “diplomë specializimi” në fushën përkatëse.

Studimet e doktoratës kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

6. ANALIZA E GJENDJES

6.1. FAKTORËT

6.1.1. Faktorët politik

Arsimi zë vend të rëndësishëm në agjendën politike të vendit, pasi shumica e popullsisë së Shqipërisë është e përfshirë në sistemin e arsimit. Megjithatë, shpenzimet publike për arsimin kanë qenë rreth 3 % të PBB-së, që është nën nivelin e vendeve të rajonit.

Nga ana tjetër Shqipëria ka normë të lartë të papunësisë së të rinjve dhe ka nevojë për harmonizim më të mirë të programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës.

Qëllimet e Politikave

Strategjia Kombëtare e Arsimit është në harmoni me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Evropë dhe në Botë.

Qëllimi i politikës A

Qëllimi i politikës B

Qëllimi i politikës X

6.1.2. Faktorët ekonomik

Në Shqipëri ka një mospërputhje ndërmjet ofertës dhe kërkesës për aftësi në tregun shqiptar të punës. Këtë e konfirmojnë anketimet me biznese që pohojnë se disa nga aftësitë e munguara janë pengesa kryesore për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Zhvillimi i kompetencave të të nxëniet dhe harmonizimi më i mirë i programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e aftësive.

Të dhënat jepen nga INSTAT

Situata ekonomike

- Të ardhurat për frymë (niveli i GDP-së)
- Degët e ekonomisë
- Të tjera fusha që ndikojnë në arsim

6.1.3. Faktorët social

Konteksti social në Shqipëri udhëhiqet nga dy zhvillime që ndikojnë në sistemin arsimor:

- Së pari, zhvillimet demografike.
- Së dyti, gjendja sociale e nxënësve.

Lëvizjet demografike të popullsisë, për arsye të migrimit dhe emigrimit, si dhe plakja e popullsisë, për arsye të uljes së lindshmërisë, janë faktorë që krijojnë mundësi për riorganizimin e rrjetit të institucioneve arsimore dhe ristrukturimit më të mirë të financimit për arsimin, në varësi të këtyre lëvizjeve.

Jepen të dhënat si:

- **Të dhënat për gjendjen sociale në periudhën e vlerësimit.**
- **Të dhënat për parashikimin e trendit të popullsisë.**

Numri i banorëve që parashikohet të ketë Shqipëria në 5 vitet e ardhshme (në milion banorë).

- **Të dhënat për parashikimin e trendit të numrit të nxënësve në SAPU.**

Numri i nxënësve që parashikohet të ketë Shqipëria në 5 vitet e ardhshme.

- **Të dhënat për parashikimin e trendit të numrit të studentëve në arsimin e lartë.**

Numri i studentëve që parashikohet të ketë Shqipëria në 5 vitet e ardhshme.

Të dhëna që do të sigurohen nga INSTAT [21]

- Prirjet lidhur me numrin e popullsisë.
- Prirjet lidhur më numrin e nxënësve.
- Prirjet lidhur me kategorinë e nxënësve, etj.

6.1.4. Faktorët teknologjik

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rajonale dhe kombëtare ka krijuar mundësi për riorganizimin e rrjetit të institucioneve arsimore të nivelit parauniversitar, por edhe të nivelit të arsimit të lartë. Po ashtu përmirësimi i infrastrukturës së telekomunikimit dhe shtrirja e përdorimit të internetit në shumicën dërrmuese të popullsisë, krijojnë kushte për integrim sa më të mirë të TIK-ut në institucionet arsimore. Zhvillimet digjitale krijojnë kushte për ndryshime cilësore në mësimdhënie, metodologji dhe në mirëadministrimin e sistemit arsimor në tërësi.

Jepen disa të dhëna si:

- Niveli i përdoruesve të internetit.
- Numri i përdoruesve të telefonave celular, në milion përdorues.
- Përqindja e nxënësve që raportojnë se e përdorin celularin.
- Niveli i përdoruesve të internetit në shkolla.
- Niveli futjes së telefonisë celulare në shoqëri, krahasimi me vendete BE-së.

6.2. ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Analiza e situatës në fushën e arsimit parauniversitar, bazohet në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe është përqendruar në pesë fusha tematike:

6.2.1. Aksesit në arsim

Lidhur me këtë fushë jepen disa të dhëna si më poshtë:

- Numri i institucioneve arsimore parauniversitare, sipas niveleve, në një hark kohor 5- vjeçar (në formë tabelare dhe grafike).
- Raporti bruto dhe neto i regjistrimit në arsimin parauniversitar, sipas niveleve, përgjatë një harku kohor 5- vjeçar (në formë tabelare).
- Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë dhe mësuesit ndihmës në shkollat e zakonshme, përgjatë një harku kohor 5- vjeçar (në formë grafike).
- Të dhëna në progres që lidhen me numrin e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive.
- Të dhëna për numrin e fëmijëve jashtë shkolle (braktisja e shkollës), etj.

Treguesit e gjendjes në periudhën e vlerësimit

Të dhëna rreth arsimit publik.

Të dhëna rreth arsimit privat.

Të dhëna për shkollat dhe raportin mësues/nxënës në shkollat me klasa të veçanta.

Të dhëna për shkollat dhe raportin mësues/nxënës në shkollat me klasa kolektive.

6.2.2. Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës

Në funksion të sigurimit të mirëqenies sociale dhe fizike të nxënësve në shkollë, jepen të dhëna që lidhen me:

- Shërbimin psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social [22].
- Përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e arsimit dhe sigurimin e arsimit cilësor.
- Përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga grupet vulnerabël, në arsimin bazë dhe të mesëm.
- Numrin e mësuesve ndihmës në shkollat e zakonshme dhe trajnimet e zhvilluara për kapacitetet e tyre profesionale.
- Arritjet mësimore të fëmijëve nga grupet vulnerabël, në veçanti të pjesëtarëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, si dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Numrin e psikologëve dhe punonjësve socialë, në funksion të cilësisë së shërbimit psiko-social.
- Konsolidimin e mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë.
- Infrastrukturën shkollore, përmirësimin dhe përshtatjen e saj.
- Edukimin për reagim ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

6.2.3. Mësuesit

Lidhur me këtë fushë jepen të dhëna për mësuesit dhe raportin mësues-nxënës në arsimin parauniversitar (në formë tabelare).

Gjatë viteve të fundit janë bërë disa përmirësime në sistem, si:

- Kuadri rregullator ka përcaktuar nivelet e diplomave për mësuesit e arsimit parauniversitar.
- Janë hartuar standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor për mësuesit në sistemin e arsimit parauniversitar [23].
- Me përfundimin e studimeve të larta të nivelit Master, nga mësuesi kërkohet të zhvillojë praktikën profesionale me kohëzgjatje një vit shkollor, pas së cilës mund t'i nënshtrohet provimit të shtetit.
- Mësuesit e certifikuar aplikojnë për punë nëpërmjet sistemit online të njohur si, portali "Mësues për Shqipërinë".
- Është krijuar portali i trajnimit të mësuesve, me prioritet aftësimi i tyre për kompetencën digjitale.
- Procesi i identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë bëhet çdo katër vjet dhe bazohet në standardet profesionale të mësuesit [24].
- Procesi i identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar - Raport 2020 [25].
- Kualifikimi i mësuesve bazohet në portofolin profesional të mësuesit dhe testin për profilin/lëndën përkatëse [26].
- Janë hartuar standardet e performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave, 2016 [27].
- Janë hartuar standardet profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar [28].

6.2.4. Zotërimi i kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës

Në funksion të analizës së situatës për këtë fushë, jepen të dhënat për paketën kurrikulare për arsimin parauniversitar, për kurrikulën me bazë kompetencat, që përfshin:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar [29].
- Kurrikulat bërthamë për nivelet 0-3: a) klasa përgatitore e arsimit fillor (I-V); b) arsimit i mesëm i ulët (VI-IX), dhe c) arsimit i mesëm i lartë (X-XII).
- Kornizën e vlerësimit të nxënësve, përfshirë nivelet e arritjeve të nxënësve për çdo shkallë të kurrikulës dhe fushë të nxëni/lëndë mësimore.
- Planin mësimor të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm si dhe planet mësimore për shkolla të veçanta (për klasat e shansit të dytë, për fëmijët e ngujuar, për shkollat speciale, për arsimin bazë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, për arsimin bazë me kohë të pjesshme, për pakicat kombëtare).
- Programe lëndore, të përgatitura për klasat dhe lëndët e arsimit bazë dhe lëndët e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje të arsimit të mesëm.
- Programet orientuese të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (VANAF), të provimeve kombëtare të arsimit bazë (PKAB) dhe të maturës shtetërore (MSH).
- Udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat dhe udhëzues kurrikularë të përgjithshëm dhe lëndorë, për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.

Jepen raportet e vlerësimeve kombëtare e ndërkombëtare të rezultateve të nxënësve

- Raporti i rezultateve të vlerësimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë.
- Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor.
- Raporti i rezultateve të vlerësimit në maturën shtetërore.
- Rezultatet e nxënësve shqiptarë në vite në testin PISA (formë tabelare).

6.2.5. Digjitalizimi i arsimit

Përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor kontribuon në zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësit, e cila është thelbësore për pjesëmarrjen në mënyrë të efektshme në shoqërinë e informacionit.

Për të zbatuar procesin e vlerësimit të kësaj fushe, jepen të dhëna mbi:

- Numrin e shkollave që përdorin të mësuarit digjital.
- Raportet kompjuter-nxënës në zona të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të arsimit.
- Rezultatet e arritura nga përdorimi i teknologjisë në procesin e të mësuarit.
- Numrin e mësuesve të trajnuar e të certifikuar për të mësuarit digjital.
- Efektet negative dhe rreziqet e përdorimit të teknologjisë në të mësuarit, etj.

6.2.6. Menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë

Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë ndahet midis tri niveleve të ndryshme:

1) Niveli qendror i përfaqësuar nga:

- Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë (sot ASCAP).
- Institucioni përgjegjës për provimet kombëtare (sot QSHA).

- Niveli qendror i institucionit përgjegjës për garantimin e ofrimit të shërbimit cilësor, nëpërmjet vlerësimit dhe inspektimit (sot DPAP).

2) Niveli rajonal/vendor i institucionit përgjegjës për garantimin e ofrimit të shërbimit cilësor i përfaqësuar nga drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar .

3) Institucioneve arsimore si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimit.

Për vlerësimin e kësaj fushe jepen të dhëna për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore parauniversitare.

6.3. BARAZIA GJINORE [30]

Për vlerësimin e këtij komponenti, jepen të dhëna për barazinë gjinore ku mangësitë më të mëdha në krahasim me BE-në hasen në fushat e njohurive, parasë dhe kohës, kurse të ngjashme janë rezultatet në fushën e punës dhe shëndetit. Ndonëse ka më shumë gra të arsimuara sesa burra në Shqipëri, ato zënë një vend relativisht më të vogël, krahasuar me nivelet e BE-së dhe objektivat kombëtare. Ndarja sipas fushave të arsimit është ende e dukshme, ku studentet femra që ndjekin arsimin e lartë përqendrohen në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies, shkencave humane dhe arteve, ndërsa studentët meshkuj, që studiojnë në këto fusha, janë të pakët.

Jepet pjesëmarrja në arsim sipas niveleve arsimore dhe gjinisë (në formë tabelare).

6.4. FINANCIMI I ARSIMIT


Analiza e nivelit të financimit është shumë e rëndësishme për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave. Kjo analizë bëhet bazuar në PBB, duke e krahasuar Shqipërinë me vendet e rajonit dhe me vendet e BE-së.

Jepen të dhënat për shpenzimet në arsimin parauniversitar për një periudhë 5- vjeçare (në formë tabelare).

7. HIERARKIA E QËLLIMEVE TË STRATEGJISË

Kronologjia e vlerësimit të performancës është në formë piramidale:

- Vizioni kombëtar për arsimin
- Qëllimet e politikave
- Objektivat specifike
- Produktet/Rezultatet e pritshme
- Masat /Veprimtaritë



Vlerësimi i performancës së sistemit realizohet duke filluar nga poshtë- lart.

8. VIZIONI KOMBËTAR PËR ARSIMIN

Në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, përcaktohet vizioni kombëtar për arsimin, i cili është hallka e parë e zinxhirit në procesin e vlerësimit.

Vizioni 2021-2026

“Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integritetin e vendit në Bashkimin Evropian”.

Vizioni për sektorin e arsimit synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin. Gjithëpërfshirja dhe barazia janë parakushte të domosdoshme për të siguruar formimin cilësor të të gjithë individëve dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale. Kompetencat për mësim gjatë gjithë jetës, janë sistem gjithëpërfshirës, i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë. Ato zhvillohen në kontekste të ndryshme formale dhe informale, në veçanti nëpërmjet arsimit cilësor.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 është zbërthyer në qëllime të politikave.

9. PROCESI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS

Procesi i vlerësimit të performancës mbështetet në vlerësimin e rezultateve të synuara në objektivat e Planit të Veprimit, hartuar në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit (SKA). Procesi i vlerësimit të performancës së sistemit arsimor bazohet në një seri të dhënash sasiore e cilësore dhe është rrjedhojë e një konsultimi të gjerë me institucionet dhe grupet e interesit, si:

- Ministria përgjegjëse për arsimin.
- Agjencitë zbatuese.
- Institucionet arsimore parauniversitare.
- Mësuesit/Prindërit/Nxënësit.
- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Organizata të shoqërisë civile.
- Institucione ndërkombëtare.

Ky proces është gjithëpërfshirës dhe mbështetet në vlerësimet në planin e brendshëm dhe të jashtëm, bazuar në dokumente strategjike, analitike dhe raportet periodike mbi gjendjen e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri. Analiza e sistemit bëhet duke u mbështetur në të dhënat statistikore të marra nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit SMIP ose, kur është e nevojshme, të dhënat merren drejtpërdrejt në terren. Një prej burimeve kryesore të të dhënave në proces është INSTAT-i.

9.1. QËLLIMI I POLITIKËS A

9.1.1. Përshkrim i përgjithshëm

9.1.2. Analiza e nivelit të realizimit të objektivave

Analiza e nivelit të realizimit të objektivit ndjek kronologjinë si më poshtë:

Objektivi A.1.

Analiza e rezultatit të objektivit A.1. (Bazuar në analizën e rezultateve të produkteve).

Produkti A.1.1.

Analiza e rezultatit të produktit (Bazuar në analizën e rezultateve të masave).

Masa A1.1.1.

Analiza e rezultateve të masës/veprimtarisë, bazuar në Pasaportën e Treguesve, të përcaktuar në SKA.

Objektivit A.N.

E njëjta procedurë si për objektivin A1.

9.1.3. Konkluzione

9.1.4. Rekomandime

9.2. QËLLIMI I POLITIKËS B

E njëjta procedurë si për qëllimin e politikës A

10. KRITERET PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS

Për vlerësimin e rezultateve të pritshme në raport me objektivat e vendosura, për realizimin e qëllimeve të politikave, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, përcaktohen kriteret, si më poshtë:

- Kriteri ligjor/Kuadri ligjor.
- Kriteri profesional/Burimet njerëzore.
- Kriteri financiar/Burimet financiare.
- Menaxhimi (Ecuria realizimit të objektivave).

Për çdo masë/veprimtari bëhet vlerësimi i nivelit të realizimit të treguesve të performancës sipas një kornize, e cila përmban:

- a) Vlerësimin e progresit të arritur në 5 nivele.
- b) Kriteret për vlerësimin e realizimit të treguesve.
- c) Përqindjen e realizimit.
- d) Nivelin e realizimit (1-5).

Niveli i realizimit të masave/produkteve/objektivave, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit, matet nëpërmjet "Indeksit të zbatimit" nga 1-5, që i përgjigjet përqindjes së realizimit të çdo mase/produkti/objektivi.

Korniza e vlerësimit të performancës (Tabela)

Vlerësimi	Kriteret	%	Niveli
Nuk ka progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungon kuadri i plotë ligjor, mungojnë aktet nënligjore si vendimet, udhëzimet, rregullat, për realizimin e objektivave/qëllimeve të politikave të SKA-së. ▪ Ka mungesë në plotësimin e strukturave. ▪ Mungojnë burimet financiare të nevojshme për mbështetjen e plotësimin të akteve nënligjore dhe strukturave institucionale. ▪ Mungojnë hapat konkretë në drejtim të menaxhimit. 	0-19%	1
Ka pak progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ekzistojnë ligjet kryesore, vendimet, udhëzimet dhe planet për realizimin e objektivave/qëllimeve të politikave të SKA-së, por ka mungesa akoma në kuadrin ligjor. ▪ Struktura institucionale është plotësuar mjaftueshëm, por ka akoma mungesa në burimet njerëzore. ▪ Mungojnë burimet financiare për të mbështetur zbatimin e plotë të objektivave. ▪ Ka hapa të ngadalshëm për realizimin e planeve të hartuara, bazuar në praktikën më të mira. 	20-39%	2
Në progres e sipër	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuadri ligjor/rregullator është miratuar në funksion të realizimit të objektivave dhe legjislacioni është në zbatim e sipër në dy vitet e fundit ▪ Struktura institucionale është e plotësuar. ▪ Ka mbështetje të pjesshme financiare në zbatim të elementëve të veçantë të kuadrit ligjor dhe politikave. ▪ Ekzistojnë praktika të mira menaxheriale për zhvillimin e veprimtarive, por ka ngecje në zbatimin e tyre. 	40-59%	3
Ka shumë progres	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimeve të politikave të SKA-së. ▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë shumë mirë. ▪ Ka mungesa në mbështetjen financiare për realizimin e plotë dhe në kohë të planeve të veprimit. ▪ Ecuria e realizimit masive/veprimtarive është e dukshme në katër vitet e fundit, bazuar në praktika të zhvilluara në zbatim të kuadrit ligjor/rregullator. 	60-79%	4
Realizuar	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë miratuar të gjitha ligjet, vendimet, udhëzimet dhe rregulloret për realizimin e qëllimeve të politikave të SKA-së. ▪ Struktura institucionale është e plotësuar dhe kapacitetet njerëzore funksionojnë shumë mirë. ▪ Financimi është në përputhje të plotë me kontekstin dhe zhvillimet në zbatim të qëllimit të politikave. ▪ Është krijuar një model i qëndrueshëm i menaxhimit institucional për zbatimin e kuadrit ligjor në katër vitet e fundit dhe ngecjet janë shumë të rralla apo të përkohshme. 	80-100%	5

Mënyra dhe teknika e vlerësimit përshkruhet në Metodologjinë e Vlerësimit të Performancës.

11. BURIMET FINANCIARE

1. Planifikimi i buxheteve për arsimin parauniversitar.

- Planifikimi i financimit për realizimin e qëllimit të politikave (A dhe B).
- Planifikimi i financimit për realizimin e objektivave.

2. Realizimi i buxheteve të planifikuara për arsimin parauniversitar.

Realizimi i buxhetit të parashikuar për arritjen e qëllimit të politikave.

Realizimi i buxhetit të parashikuar për arritjen e objektivave.

Tabelat, lidhur me fondet në periudha kohore dhe realizimi i tyre

- Planifikimi i fondeve.
- Përdorimi i fondeve.
- Objekti i përdorimit të fondeve.
- Mënyra e përdorimit.
- Efektiviteti i përdorimit.

12. RAPORTI I VLERËSIMIT

Raporti i Vlerësimit të Performancës së Sistemit Arsimor Parauniversitar (në vijim Raporti) është dokumenti kryesor i raportimit. Raporti jep një informacion të gjerë për publikun dhe shërben si mjet llogaridhënieje, duke evidentuar strukturat përgjegjëse lidhur me progresin e arritur. Raporti shërben si orientim për hartuesit e politikave arsimore, duke theksuar sfidat kryesore me të cilat përballet sistemi ynë arsimor.

Monitorimi dhe raportimi i realizimit të objektivave është thelbësor për zbatimin proporcional të strategjisë. Mbledhja e rregullt e informacionit, lidhur me zbatimin e objektivave të SKA-së, i krijon mundësi Qeverisë për të bërë rregullime të vazhdueshme, para fazës së fundit të vlerësimit.

Në funksion të krijimit të mekanizmave për monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm për nivelin e realizimit të objektivave në fushën e arsimit parauniversitar, duhet të krijohet një sistem informatik, që monitoron në kohë reale ecurinë e realizimit të treguesve dhe ndihmon për vendimmarrjet në kohë. Për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e rezultateve, është me rëndësi ndërtimi i një matrice të qartë të raportimit, ku të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhshme.

Raporti do të integrojë dhe harmonizojë formatet e raportimeve të deritanishme të institucioneve arsimore, në qendër dhe në bazë, do të bëjë analizën e integruar të të gjitha të dhënave të sistemit, bazuar në qëllimin e politikave dhe do të paraqesë vlerësimin e performancës së sistemit, shoqëruar me rekomandimet përkatëse, në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Raporti hartohet sipas një formati të përcaktuar (shih aneksin 2).

13. KONKLUZIONE

Konkluzionet, lidhur me vlerësimin e efikasitetit të politikave, do të jepen lidhur me dy çështjet e mëposhtme:

1. Funksionimi i sistemit arsimor parauniversitar

- Funksionimi i sistemit arsimor parauniversitar në raport me qëllimin e politikave.
- Arritjet më të mëdha gjatë periudhës njëvjeçare për secilën prej politikave.
- Problematikat më të mëdha të evidentuara gjatë periudhës njëvjeçare për secilin qëllim.
- Rezultatet e arritjeve gjatë vitit përkatës.
- Masat e marra: rishikimet, studimet dhe vlerësimet që janë kryer dhe rezultatet që kanë dhënë.
- Nevoja e ndryshimit ose jo të qëllimit të politikave të SAPU-së.
- Ndërhyrjet më të domosdoshme me qëllim përmirësimin e defekteve të evidentuara.

2. Mbështetja financiare për sistemin arsimor parauniversitar

- Niveli i financimit nga qeveria dhe nga partnerët, bazuar në qëllimin e politikave.
- Përputhshmëria e ndarjes së buxhetit të sotëm me prioritetet e politikës arsimore.
- Raportet ndërmjet shpenzimeve administrative (paga, shpenzime, asistencë teknike, trajnime dhe investimeve në arsim).
- Kontributi i donatorëve dhe masa e ndikimit në realizimin e pritshmërive.
- Përparimi kundrejt parimeve të strategjisë për arsimin gjithëpërfshirës dhe arsimimin e shtresave në nevojë.

14. REKOMANDIME

- Rekomandime lidhur me cilësinë e performacës së sistemit.
- Rekomandime lidhur me përgjegjësitë e aktorëve/strukturave.
- Rekomandime lidhur me hartimin e politikave të reja.

15. FORMATET E VLERËSIMIT

ANEKSI 1: Formatet e vlerësimit të performancës së SAPU

Modeli 1: Formati i vlerësimit të realizimit të masës/veprimtarisë

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË MASËS/VEPRIMTARIË - Indeksi 1-5				
Nr.	Masa/Veprimtaria	Treguesit e matjes	Realizimi %	Vlerësimi 1-5
X.N.N.N.	Përshkrimi i masës/veprimtarisë	T1	%	Indeksi 1-5
		TN	%	
	Vlerësimi i realizimit të masës/veprimtarisë X.N.N.N.		% mesatare	

Modeli 2: Formati i vlerësimit të realizimit të produktit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË PRODUKTIT (1-5)			
Nr.	Produkti	Masa/Veprimtaria	Vlerësimi
X.N.N.	Përshkrimi i produktit	X.N.N.1	Indeksi
		X.N.N.N	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të produktit X.N.N.		Indeksi mesatar

Modeli 3: Formati i vlerësimit të realizimit të objektivit

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË OBJEKTIVIT (1-5)			
Nr.	Objektivi	Produkti	Vlerësimi
X.N.	Përshkrimi i objektivit	X.N.1.	Indeksi
		X.N.N.	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të objektivit X.N.		Indeksi mesatar

Modeli 4: Formati i vlerësimit të realizimit të qëllimit të politikës

VLERËSIMI I REALIZIMIT TË QËLLIMIT TË POLITIKËS (1-5)			
Nr.	Qëllimit i politikës	Objektivi	Vlerësimi
X	Përshkrimi i qëllimit të politikës	X.1.	Indeksi
		X.N.	Indeksi
	Vlerësimi i realizimit të qëllimit të politikës X		Indeksi mesatar

Modeli 5: Formati i vlerësimit të performancës së sistemit

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SAPU		
	Qëllimi i politikës	Vlerësimi 1-5
PERFORMANCA E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR	Përshkrimi i qëllimit të politikës 1	Indeksi mesatar
	Përshkrimi i qëllimit të politikës X	Indeksi mesatar
	Vlerësimi i performancës së SAPU-së	Indeksi mesatar P1-PN

ANEKSI 2: Formati i raportit të vlerësimit të performancës

NR.	RUBRIKA	PËRSHKRIMI I RUBRIKËS	VËREJTJE
1	Hyrje	Në hyrje do të përshkruhet shkurtimisht përmbajtja e raportit.	
2	Grupi hartues i raportit Grupi ndihmës/kontribues	-Në këtë rubrikë vendosen emrat e hartuesve të raportit dhe kontribuesve të brendshëm ose të jashtëm. -Vendosen emrat e institucioneve që përfaqësojnë hartuesit.	
3	Përmbajtja e raportit	Në këtë rubrikë vendoset përmbajtja e raportit të vlerësimit.	
4	Shkurtesat e emrave të institucioneve	Në këtë rubrikë vendosen emrat e shkurtuar të institucioneve që përmenden në raport.	
5	Parimet e vlerësimit të performancës	Në këtë rubrikë vendosen parimet e vlerësimit të performancës dhe shpjegohet sigurimi i tyre gjatë procesit.	
6	Qëllimi i vlerësimit të performancës	Në këtë rubrikë vendoset qëllimi i vlerësimit në kontekstin e raportimit.	
7	Fusha e veprimit	Në këtë rubrikë vendoset fusha e veprimit, duke cilësuar se çfarë është vlerësuar.	
8	Përgjegjësitë për vlerësimin	Në këtë rubrikë shpjegohet, se sa janë realizuar përgjegjësitë për vlerësimin e performancës nga institucioni drejtpërdrejt përgjegjës dhe nga institucionet ndihmëse.	
9	Metodologjia e vlerësimit	Në këtë rubrikë shpjegohet mënyra se si është realizuar vlerësimi.	
10	Vizioni kombëtar për arsimin	Në këtë rubrikë citohet "Vizioni kombëtar për arsimin" i përcaktuar në SKA.	
11	Konteksti i vlerësimit të sistemit	Në këtë rubrikë përshkruhet konteksti makroekonomik ku përfshihet: - Kuadri makro-ekonomik dhe fiskal - Situata demografike - Kuadri i politikave - Kuadri ligjor dhe institucional	

12	Analiza e gjendjes	Në këtë rubrikë bëhet analiza e gjendjes ku përfshihen: - Mjedisi me aktorët ekonomikë, politikë, social dhe teknologjikë. - Arsimi parauniversitar - Barazia gjinore - Financimi i arsimit	
13	Korniza e vlerësimit	Në këtë rubrikë përshkruhen kriteret dhe nivelet e vlerësimit të produkteve, objektivave dhe qëllimit të politikave.	
14	Vlerësimi i performancës	Në këtë rubrikë nëpërmjet përdorimit të indeksit të vlerësimit jepen formatet e vlerësimit të performancës, niveli i realizimit të produkteve për secilin objektivi.	
15	Burimet financiare	Tabela e burimeve financiare, të parashikuara dhe të përdorura, vendoset në fund të analizës, lidhur me nivelin e realizimit të çdo produkti/objektivi.	
16	Konkluzione	Kjo rubrikë vendoset në fund të analizës lidhur me nivelin e realizimit të çdo mase/produkti/objektivi.	
17	Rekomandime	Kjo rubrikë vendoset pas çdo konkluzioni, lidhur me nivelin e realizimit të çdo produkti/objektivi/qëllimi.	
18	Anekset	Kjo rubrikë vendoset në pjesën e fundit të Raportit të Vlerësimit.	
19	Referencat ligjore	Kjo rubrikë do të vendoset në fund të raportimit, duke listuar referencat, ku janë bazuar hartuesit e raportit.	

16. REFERENCAT

- [1] Ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*, MASR.
- [2] MASR, Udhëzim Nr. 12, datë 10.6.2021 *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në njëvend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*.
- [3] Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”*, Tiranë 2021.
- [4] UNESCO, *“Unpacking Sustainable Development Goal 4- Education 2030,”* 2017.
- [5] OECD, *Education at a Glance 2020: OECD Indicator*, Paris: OECD Publishing, 2020.
- [6] MASR, *“Të dhënat për arsimin parauniversitar 2019-2020”*, 2020.
- [7] Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 51, datë 26.1.2022 *“Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2022–2024”*.
- [8] Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 276, datë 12.5.2021 *“Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”*.
- [9] Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 701, datë 18.11.2021 *“Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve, 2021–2025”*.
- [10] Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 735, datë 3.12.2021 *“Për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2022–2024”*.
- [11] Këshilli i Ministrave, Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, 2020.
- [12] VKM nr. 400, datë 30.6.2021 *“Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021 - 2030, dhe të planit të saj të veprimit”*.
- [13] European Commission, *Albania 2020 Report - Communication on EU Enlargement Policy*, 2020.
- [14] European Union, *“Council Resolution on a strategic framework for European cooperation in education and training towards the European Education Area and beyond (2021-2030)”* 2021.
- [15] UNESCO, *“Albania: education policy review; lissues and recommendations, extended report”*, Paris, 2017.
- [16] OECD, *“OECD Reviews of Evaluation and Assessment: Albania”*, OECD Publishing, Paris, 2020.
- [17] 2030, Agenda - *“Sustainable Development 2030”*.
- [18] VKM Nr. 98, datë 27.02.2019, *“Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”*.
- [19] VKM Nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”*.
- [20] VKM Nr. 540, dt. 19.09.2018 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar e mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre”*.
- [21] INSTAT, *Hipotezat e Projeksioneve të Përditësuara të Popullsisë 2019 - 2031*, 2019.
- [22] Urdhër Nr. 313 datë 20.10.2020, *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”*.
- [23] Urdhër Nr. 246, dt. 24.07.2020, *“Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar, 2020”*.
- [24] ASCAP, *Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar, 2021*.

[25] ASCAP, *Nevojat për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar - Raport*, 2020.

[26] MASR, Urdhër 195. 25.04.2016 *"Për miratimin e dokumentit "Edukimi dhe formimi. Profili i mësuesit gjithëpërfshirës"*, 2016.

[27] MASR, Urdhër Nr. 467, datë 15.09.2016, *"Për miratimin e standardeve të performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave*, 2016.

[28] MASR, Urdhër Nr. 477, datë 30.09.2019, *"Për miratimin e standardeve profesionale për formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar*, 2019.

[29] MASR, *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, 2014.

[30] INSTAT, *"Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020"*, 2020.

HARTOI MANUALIN:

GRUPI KRYESOR

Gerti Janaqi
Bashkim Muça

GRUPI NDIHMUES

Redian Dengeri
Lindita Çifçi
Ermal Kola
Etleva Lundra
Adela Iljazi
Mirela Kondili
Erjola Shehaj
Albina Nuredini